

Dita Botërore e Popullsië

Planifikimi i familjes dhe çështjet
e popullsisë në Kosovë

Dr. Mimoza DUSHI

Prishtinë, 11. 07.2012

Përmbajtja

- Hyrje
(koncepti: Planifikim i familjes)
- Popullsia e Kosovës
(numri i popullsisë, ndryshimet në nivelin e fertilitetit)
- Planifikimi i familjes në Kosovë
(gatishmëria e femrave në shoqërinë kosovare që të planifikojnë familjet e tyre)
- Përfundim

Hyrje

- planifikimi i familjes
 - në aspektin ekonomik = mundëson planifikim i numrit të fëmijëve në harmonizim me të ardhurat materiale të familjes
 - në aspektin shoqëror = është metodë parandaluese për lindjet e paplanifikuara, sidmos në shmangjen e aborteve dhe mundëson krijim i kushteve individuale të lindjes, rritjes dhe edukimit të fëmijëve
 - në aspektin mjekësor = mundëson që të rruhet shëndeti i nënës dhe fëmijës dhe përfaqëson metodat kurative për trajtimin e jo fertilitetit dhe sterilitetit bashkëshortor

- planifikimi i familjes, si program për herë të parë del në skenë në 60-ta, por koncepti më i plotë i saj del nga Konferenca e Pestë Botërore mbi Popullsinë, Kajro 1994
 - u siguron çifteve lirinë e vendosjes dhe përgjegjësinë mbi numrin e dëshiruar të fëmijëve dhe intervalin kohor në mes tyre
 - u siguron informata mbi përdorimin dhe furnizimin me metoda të planifikimit të lindjes, përfshirë këtu edhe informatat mbi shërimin nga steriliteti që d.m.th. se nuk përpiqet për më shumë apo më pak fëmijë, por nënkupton ndryshimin dhe cilësinë e marrëdhënieve njerëzore
 - synon që në familje të vijë fëmija i dëshiruar dhe gruaja e cila është në marrëdhënie pune, të mos privohet nga amësia për shkak të obligimeve që ka në vendin e punës

Popullsia e Kosovës

- vlerësohet se ka rreth 2.5 milion banorë
 - regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 = 1 722 872 banorë
- popullsi shumë e re
 - moshë mesatare 25.3 vjet
 - 32.8 % nën 14 vjet ose mbi 50% nën 25 vjet
 - 6.6% e popullsië mbi 65 vjet
- aktiviteti ekonomik
 - 58% popullsi ekonomikisht aktive
 - 46% e punësuar
 - 54% e papunësuar
 - 42% popullsi ekonomikisht jo aktive


Ndryshimi i nivelit të fertilitetit

- në aspektin teorik ndryshimet në shkallën e lindshmërisë kanë filluar pas LIIB
 - investime në ekonomi (industrinë e rëndë)
 - inkuadrimi i pamjaftueshëm i femrës në proceset ekonomike
 - kohë të mjaftueshme të merret me lindjen dhe rritjen e fëmijëve
 - shkalla e natalitetit afër 50 promilë në vit ose norma e fertilitetit të përgjithshëm ishte afërsisht 8 fëmijë për grua
 - shoqëria shqiptare vazhdoj të mbetet agrare

- pas viteve të 60-ta
 - fillojnë investimet në ekonomi (industrinë e lehtë)
 - hapet Universiteti i Prishtinës (1970)
- mirëpo, shkalla e lindjeve mbetet ende e lartë (6.73 fëmijë për grua)
 - zvogëlohet shkalla e mortalitetit infantil
 - shënohet shtimi më i madh natyror i popullsisë

- ndryshimet reale ndaj lindjes dhe numrit të pasardhësve fillojnë tek pas vitit 2000
 - migrimet fshat – qytet që sjellin ndryshimin e strukturës urbane të vendit
 - ndryshim i ekonomisë
 - sektorët primarë zëvendësohen me sektorët terciarë
 - krijohen kushte më të favorshme për punësimin e femrës
 - rritet kërkesa për fuqi punëtore të kualifikuar
 - largon fëmijët nga procesi i punës

- kjo situatë spontanisht imponon nevojën për planifikim të familjes
 - hyjnë më vonë në martesë
 - janë më aktive në planifikimin e familjes,
 - realizojnë numër më të vogël të lindjeve



Gatishmëria e femrave në shoqërinë shqiptare në Kosovovë që të planifikojnë familjet e tyre

- hulumtimi shkencor i realizuar në Spitalin Gjinekologjik në QKUK në vitin 2007
 - janë intervistuar 1000 femra
 - në moshë të riprodhimit, 15-49 vjet dhe
 - aktive në procesin e riprodhimit
- sjellja riproduktive e femrave është mat me tri kategori të pyetjeve
 - qëndrimi mbi numrin e fëmijëve
 - qëndrimi mbi përdorimin e planifikimit të familjes
 - sipas ndërprerjes së shtatzënësive të paplanifikuara, aborteve
- analizuar sipas
 - variablave demografike
 - variablave socio-ekonomike

Variablat demografike


- mosha është faktori kryesor i sjelljes riprodhuese
 - femrat e moshuara (35-49 vjet) përdorin më shumë planifikimin e familjes se sa ato në moshë të re
 - femrat e moshës së re kanë frikë se mund të kenë pasoja në shtatzënësitë e tyre në të ardhmen
 - femrat e moshuara kanë arritur numrin e dëshiruar të fëmijëve
- Statusi martesor = kohëzgjatja në martesë
 - me kalimin e viteve rritet numri i fëmijëve dhe përdorimi i planifikimit të familjes
 - kohëzgjatja në martesë është variabla që ka më së shumti ndikim në përdorimin e kontraktivëve
 - për çdo pesë vjet martesë, 39.8% rriten gjasat për përdorimin e kontraktivëve

Variablat socio-ekonomike

- femrat e shkolluara dhe të punësuarra kanë arritur të sigurojnë një bazë ekonomike
 - marrin pjesë aktive në çështjet mbi planifikimin e familjes
 - koordinojnë kohën të cilën e shpenzojnë në punë dhe me familjen
 - kryesisht realizojnë dy lindje të gjalla
- analiza tregon rëndësinë e pozitës në profesion dhe nivelit të të ardhurave mujore
 - pozita më e mirë në punë + të ardhura më të larta mujore = numër më i vogël i fëmijëve


- të pashkolluara dhe të papunësuarra kanë status me të ulët social, jetojnë kryesisht në vendbanime rurale dhe në familje të mëdha
 - nuk kanë qëndrime të qarta mbi sjelljen riprodhuese
 - familjet e tyre “planifikohen” nga bashkëshortët
 - realizon numër të madh të lindjeve
 - mesatarisht gjashtë fëmijë për grua

- Aborti ende shfrytëzohet si formë e planifikimit të familjes
- Arsyet e marrjes së vendimit për abort





Faktorët e jashtëm – familja

Ndikimi i bashkëshortit në PF



Ndikimi i anëtarëve tjerë në PF



- Statusi socialo-ekonomik i familjes
 - përdorim më të ulët të planifikimit të familjes kanë femrat, burrat e të cilave nuk punojnë ose punojnë punë fizike
 - jetojnë në familje të mëdha dhe shpesh me kushte të rënda ekonomike
 - kanë numër të madh të fëmijëve me interval të shkurtë intergjenezik
 - ka raste kur edhe fëmijët janë prodhues në ekonominë familjare

- përdorim më të lartë të planifikimit të familjes kanë femrat, burrat e të cilave kanë nivele më larta shkollimi, punojnë punë profesionale
 - jetojnë në familje nukleare, me kushte më të mira ekonomike dhe kanë prestigj më të lartë shoqëror
 - kanë numër të vogël të fëmijëve me interval më të gjatë intergjenezik
 - fëmijët janë konsumues në ekonominë familjare

Përfundimi

- sjellja riprodhuese te femrat shqiptare në Kosovë është duke ndryshuar
 - në varshmëri me pozitën e femrës në shoqëri
- ndryshimi i sjelljes riprodhuese individuale patjetetër se reflektohet në nivelin shoqëror
 - përcaktimi i femrës për numër më të vogël të fëmijëve dalëngadalë do të ndryshojë normën e fertilitetit të përgjithshëm
- nevojitet transformim më i madh mbarëshoqëror
 - niveli i tashëm i emancipimit të femrës në shoqërinë shqiptare në Kosovë nuk duket i mjaftueshëm aq sa të ndryshojë qëndrimet mbi lindshmërinë në formë masive
 - edhe për një kohë profesionet kryesore të femrës do të vazhdojnë të mbesin amësia dhe prindëria

Faleminderit!